



Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Përzgjedhja dhe Efektet e Sistemeve Elektorale në Shqipëri

Arjan Dyrmishi

Tiranë, 2010

Abstrakt

Institucioni i zgjedhjeve të lira është një nga kriteret bazë të demokracisë. Në mënyrë që të përmbushet ky kriter është e domosdoshme që të përzgjedhet një sistem elektoral i cili të mbështetet në dy parime kryesore, garantimin e një përfaqësimi sa më proporcional dhe realizimin e një qeverisje të qëndrueshme. Një sistem elektoral i ekuilibruar ndërmjet këtyre dy parimeve mund të kontribuojë në mënyrë të konsiderueshme në procesin e demokratizimit dhe stabilitetit qeverisës dhe për pasojë është një nga vendimet më të rëndësishme që merr një demokraci. Por ndërsa në demokracitë e konsoliduara sistemet elektorale përbëjnë një nga elementet më konservative, në Shqipëri sistemi është ndryshuar, megjithse në përmasa të ndryshme, në të gjitha zgjedhjet e zhvilluara që prej vitit 1991. Duke parë këtë tendencë, ky studim analizon sistemet elektorale të aplikuara në zgjedhjet Shqiptare, së bashku me motivet dhe rrethanat e përzgjedhjes së tyre, si dhe bën një vlerësim të efekteve që këto sisteme kanë prodhuar në strategjitë elektorale dhe sjelljen e partive politike por dhe më gjerë, në sistemin e partive, në përfaqësimin e tyre në parlament dhe formimin e qeverive.

Fjale kyçe: *sistem elektoral, demokraci, sistemi partive, shpërpjestueshmëri përfaqësim*

Hyrje

Ndryshimi i sistemit miks proporcional në prag të zgjedhjeve të vitit 2005 ishte tentativa e fundit për të shpëtuar një sistem i cili përdorej që nga viti 1992 por që përveç herës së parë kishte prodhuar vetëm zgjedhje me rezultate të kundërshuara. Ndryshimet e vazhdueshme të formulës dhe strategjitë për anashkalimin e sistemit e kishin vënë në diskutim integritetin e tij. Shpërpjestueshmëria e pazakontë midis votave dhe vendeve në parlament që prodhuan zgjedhjet e vitit 2005 e forcuan bindjen se ky sistem ishte i pazbatueshëm.

Në këto kushte, megjithë kundërshtitë që lindën për mënyrën se si u arrit, amendimi i Kushtetutës dhe ndryshimi i sistemit elektoral nga dy partitë më të mëdha politike, Partia Socialiste (PS) dhe Partia Demokratike (PD), mund të konsiderohet si një përpjekje për të gjetur një sistem i cili të ishte më i zbatueshëm. Por destabiliteti politik që rezultoi pas zgjedhjeve të realizuara me sistemin e ri dhe diskutimet për një reformë të re të sistemit elektoral treguan se edhe ky sistem nuk rezultoi i qëndrueshëm dhe duket se do të jetë çështje kohe derisa të ndryshojë përsëri.

Nëpërmjet analizës së sistemeve elektorale të përdorura në zgjedhjet legjislative në Shqipëri ky studim përpiqet të shpjegojë stimujt që kanë çuar në përzgjedhjen e tyre dhe masën në të cilën efektet e prodhuara nga sistemet e përzgjedhura kanë nxitur ndryshime të mëtejshme. Studimi mbështet hipotezën se ndryshimet e vazhdueshme të sistemit elektoral nuk janë nxitur nga interesi për zhvillimin e demokracisë, krijimin e rregullave të ndershme të konkurimit dhe përfaqësim sa më i drejtë por janë udhëhequr nga vlerësimi mbi përfitimin apo humbjen e mundshme të votave dhe përfitimi i menjëhershëm elektoral.

Studimi është i organizuar në tre pjesë. Pjesa e parë, sjell një pasqyrë të literaturës mbi sistemet elektorale, llojet e sistemeve më të përdorura dhe kriteret normative të vlerësimit të tyre sipas efekteve. Pjesa e dytë analizon sistemet e përdorura në Shqipëri, kushtet dhe premisat e përzgjedhjes së tyre si dhe efektet që ato kanë prodhuar në strategjitë elektorale, sistemin e partive, përfaqësimin në parlament dhe në qeverisje. Pjesa e fundit sjell disa konkluzione të bazuara në gjetjet e këtij studimi.

Megjithë rëndësinë e aspekteve administrative të zgjedhjeve si regjistrimi i votuesve, organet përgjegjëse për organizimin e zgjedhjeve dhe si zgjidhen ato, përzgjedhja e kandidatëve etj, ky studim nuk ndalet në to.

Pritshmëritë teoriko normative

Në demokraci sistemet elektorale përkufizohen si një tërësi rregullash të pandryshueshme zgjedhore me anë të të cilave kryhen një ose më shumë zgjedhje (Lijphart 1999). Ato shërbejnë për të përkthyer votat e hedhura në votimet e përgjithshëm në vende në parlament për partitë dhe kandidatët e tyre.

Demokracia është një sistem i cili prodhon fitues dhe humbës dhe partitë politike konkurruese edhe mund t'i humbasin zgjedhjet. Për këtë arsye në këtë sistem të pasigurisë së institucionalizuar siç është demokracia (Przeworski 1991), sistemet elektorale shërbejnë si mekanizëm për shmangien e faktorit rastësi në rezultatet e ballafaqimeve politike (Birch, 2007). Sistemet elektorale janë me rëndësi kyçe për stabilitetin e demokracisë pasi edhe në rastet kur i humbasin zgjedhjet aktorët politikë e pranojnë rezultatit dhe shohin tek zgjedhjet e ardhshme mundësinë për të përmbushur interesat e tyre në një kohë tjetër.

Për arsye se sistemet elektorale tradicionalisht kanë qënë një ndër institucionet më të stabilizuara të demokracive tradicionale ato janë trajtuar nga literatura si variabla të pandryshueshme për të analizuar sistemin e partive (Duverger 1954), koalicionet qeverisëse, përfaqësueshmërinë apo edhe vetë modelet e demokracisë (Lijphart 1999).

Rëndësia e sistemeve elektorale mori një vëmëndje tjetër në kuadër të Valës së Tretë të demokratizimit, kur demokracitë post-komuniste por dhe më gjerë u vunë në kërkim të gjetjes së rregullave sa më të përshtatshme të konkurrencës politike (Bielasiak 2006). Po kështu sfidat ndaj legjitimitetit qeverisës në demokracitë e stabilizuara (Norris 1997) dhe rritja e numrit të demokracive e ktheu përzgjedhjen e sistemeve elektorale në një çështje të rëndësishme politike në shumë vende të globit (Matt Golder 2005).¹

Këto zhvillime sollën edhe spostimin gradual të vëmëndjes drejt interesit për origjinën politike të sistemeve elektorale, pasi miratimi ose ndryshimi i rregullave të votimit ishte në dorën e aktorëve të cilët do të ishin konkures në zgjedhjet e ardhshme dhe eventualisht humbës. Kështu nëpërmjet studimit të sistemeve elektorale si variabël e ndryshueshme u gjenerua një korpus i ri literature i cili analizon ndikimin e institucioneve të tjera politike dhe efektet mbi sistemet elektorale (Simon 1997, Lewis 2001, Bielasiak 2005, Benoit 2004). Gjetja e Duverger se sistemet elektorale janë mekanizma të cilët funksionojnë njëkohësisht edhe kamera edhe projektorë duke rregjistruar pamje të cilat pjesërisht i kanë krijuar vetë (Duverger 1984)

1. Praktikisht çdo vend i pavarur sot në botë ka mbajtur zgjedhje në kohë të ndryshme, përveç tetë vendeve: Bhutani, Brunei, Kina, Eritrea, Katari, Arabia Saudite, Somalia, Emiratet e bashkuara Arabe.

më së miri reflekton funksionin e dyfishtë të sistemeve elektorale.

Në funksion të sistemit elektoral, efektet mbi rezultatin e zgjedhjeve mund të jenë dramatike. (Tabela 1 dhe 2) (Reynolds, Reilly & Ellis 2005).

Siç shihet, nëpërmjet mënyrës se si përkthehen votat në vende në parlament, sistemi elektoral ndikon drejtpërsëdrejti mbi përbërjen e parlamentit dhe qeverisjes. Por efektet e sistemeve elektorale shkojnë edhe më tej pasi ato kanë ndikim afatgjatë mbi sistemin e partive, organizimin e spektrit ideologjik natyrën e konkurrencës dhe për pasojë në strategjitë elektorale dhe qeverisëse të partive politike (Duverger 1954, Dahl 1971, Riker 1982, Sartori 1976, Lijphart 1999).

Sistemet elektorale ndikojnë edhe në kohezionin e brendshëm të partive politike sepse sistemet me formula mazhoritare krijojnë më shumë hapsira për aktorët politikë individuale dhe nxisin fraksionet brenda partive ndërkohë sistemet proporcionale nxisin kohezion dhe unitet në qëndrimet partiake (Reynolds, Reilly & Ellis 2005). Por mbi të gjitha sistemi elektoral ndikon mbi marrdhëniet ndërpartiake pasi nëse një sistem nuk konsiderohet i ndershëm, dhe humbësit e shohin fitoren në zgjedhje si të pamundur, kjo mund të çojë në destabilitet dhe qëndrime anti-sistem të aktorëve politikë (Sartori 1976).

Sistemet elektorale ndryshojnë në funksion të disa elementëve përbërës të tyre siç janë madhësia e zonës zgjedhore,² madhësia e legjislaturës,³ struktura e votës,⁴ formula matematike për shpërndarjen e vendeve,⁵ apo listat zgjedhore të partive.⁶ Por elementi më i rëndësishëm i një sistemi zgjedhor është formula elektorale e cila është dhe në themel të kategorizimit të sistemeve. Kështu në funksion të kësaj formule sistemet elektorale ndahen në tre tipe kryesore: Sistemet Mazhoritare, Sistemet Proporcionale dhe Sistemet Gjysëm-proporcionale (Lijphart 1999, Norris 1997, Reynolds, Reilly & Ellis 2005).

Sistemet mazhoritare bazohen në metodën fituesi-merr-gjithshka dhe kanë prirje të nxjerrin një fitues absolut dhe një seri humbësish duke prodhuar modelin e demokracisë mazhoritare (Lijphart 1999). Sistemet mazhoritare ushtrojnë ndikim nëpërmjet faktorit 'mekanik' dhe atij 'psikologjik' mbi sistemin e partive duke prodhuar sistem dy-partiak (Duverger 1954). Faktori mekanik ka të bëjë me faktin se vetëm partitë e mëdha mund të fitojnë në zgjedhje kurse faktori psikologjik përforcon atë mekanik pasi votuesit orientohen drejt mbështetjes për një nga dy partitë e mëdha në mënyrë që vota e tyre 'të mos shkojë dëm'. Por faktori psikologjik ndikon edhe mbi politikanët të cilët u bashkohen partive të mëdha në vend që të shpenzojnë

2. Për shëmbull, nëse përdoret sistemi proporcional kombëtar madhësia e zonës është maksimale, pasi nga një zonë e vetme dalin të gjithë deputetët për në parlament. Në rastin kur përdoret sistemi mazhoritar, madhësia e zonës është më e vogla e mundshme pasi nga një zonë del vetëm një deputet por vendi është i ndarë në atë zona sa ka dhe vende në parlament.

Në rastin e sistemit proporcional rajonal, madhësia e zonës kushtëzohet nga numri i votuesve dhe kështu zonat rezultojnë me madhësi të ndryshme. 3. Madhësia e legjislaturës është me shumë rëndësi nëse numri i vendeve në parlament është më i vogël se 100, pasi në këtë rast shanset e hyrjes në parlament të partive të vogla minimizohen në mënyrë të konsiderueshme.

4. Struktura e votës e cila ka të bëjë me faktin nëse votuesit votojnë për persona apo parti politike dhe nëse votuesit mund të shprehin vetëm një preferencë apo më shumë se një.

5. Formulatat më të përdorura për përkthimin e votave në vende janë formula D'Hondt e cila përdor përpjestues si 1, 2, 3..., dhe formula Saint-Laguë, e cila përdor përpjestues si 1, 3, 5, 7... Përveç këtyre formulave të cilat përdorin metodën e mesatares më të lartë, përdoret dhe formula e Kuotës Hare e cila është e kundërta e mesatares më të lartë. Sipas Kuotës Hare numri i total i votave të fituara nga të gjitha partitë pjestohet me numrin e vendeve në parlament dhe shuma që del përdoret si përpjestues.

6. Listat zgjedhore mund të jenë të hapura, që do të thotë se votuesit mund të votojnë për partitë politike por kanë mundësi që të zgjedhin brenda listës edhe kandidatën, ose të mbyllura kur votuesit votojnë për partinë dhe kandidatët përcaktohen nga kjo e fundit.

energjitë për të konkuruar me parti, shanset e fitores të të cilave janë të ulta. Për arsye se sistemet mazhoritare i japin partive të mëdha shumicën e vendeve në parlament edhe kur ato nuk marrin shumicën e votave ato ndikojnë mbi përfaqësueshmërinë pasi prodhojnë shpërpjetueshmëri të lartë. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi numrin e partive pasi sa më e lartë⁷ të jetë shpërpjetueshmëria, aq më shumë zvogëlohet numri i partive që hyjnë në parlament. Të gjithë sistemet elektorale prodhojnë shpërpjetueshmëri, por në sistemet proporcionale shpërpjetueshmëria është më e ulët.

Një nga aspektet e kritikueshme të sistemeve mazhoritare është se qeveria teorikisht kontrollohet nga parlamenti, por në praktikë duke qënë se përbëhet nga udhëheqës të së njëjtës parti politike ajo në fakt dominon mbi parlamentin. Në këtë mënyrë, më shumë se sa një sistem parlamentar, demokracia mazhoritare shihet si përqëndrim i pushtetit tek një sistem dypartiak i disiplinuar dhe i dominuar nga ekzekutivi (Lijphart 1999).

Në ndryshim nga sa më sipër, sistemet proporcionale prodhojnë disa fitues të pjesshëm, më pak humbës se sa sistemet mazhoritare. Shpërndarja e forcës parlamentare dhe nevoja për konsensus e shtyn modelin e demokracisë drejt konsensualizmit. Por sistemet proporcionale paraqesin problem pasi fragmentimi i partive politike mund të rrezikojë menaxhueshmërinë dhe stabilitetin e qeverisjes. Për këtë arsye sistemet proporcionale aplikojnë pragje elektorale të cilat mund të jenë relativisht të larta në mënyrë që të shmangin fragmentimin. Duke qënë se në parlament mund të përfaqësohen edhe parti shumë të vogla, të cilat nuk mund të numërohen më të njëjtin kriter si partitë e mëdha, në këtë studim do të përdoret koncepti i 'numrit efektiv të partive parlamentare' për të matur nivelin e përqëndrimit të partive.⁸

Sidoqoftë sistemet mazhoritare janë demokratike në thelb dhe lejojnë funksionimin normal të një demokracie liberale. Në shumë demokraci të stabilizuara, kryesisht në vendet Anglo-Saksone dhe vendet e influencuara nga to, sistemet mazhoritare vazhdojnë të jenë të preferuara kundrejt atyre proporcionale (Golder 2005). Për arsye se prodhojnë përfaqësueshmëri më të mirë, sistemet proporcionale kanë rezultuar të suksesshme në nxitjen e procesit të demokratizimit (Bielasiak 2006) dhe përdoren pothuaj në të gjitha demokracitë ish-komuniste të EQL (Birch 2005).

Siç do të shohim, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme të sistemit por edhe për shkak të kurbës që ka ndjekur përzgjedhja e tyre,⁹ megjithëse bie në kategorinë e vendeve post-komuniste Shqipëria përbën një rast specifik.

7. Shpërpjetueshmëria në rezultatet e zgjedhjeve konsiston në diferencën ndërmjet përqindjes së votave të marra dhe përqindjes së vendeve të fituara në parlament nga një parti.
8. Formulë për nxjerrjen e NEPP është gjeneruar nga Markku Laasko , ku N është numri i partive, n është numri efektiv i partive më të paktën një vend në parlament, dhe katrori i proporcionit të të gjithë vendeve të secilës parti.
9. Megjithëse sistemi proporcional rajonal hyn në kategorinë e sistemeve proporcionale ai mezi që mund të kategorizohet si i tillë. Në Spanjë sistemi nuk prodhon proporcionalitet për arsye të madhësisë së zonave elektorale (të 50 rajonet kanë nga 2 vende). Në Greqi sistemi proporcional rajonal përdor një formulë të ashtuquajtur e përforcuar, por ajo më tepër është një emërtim çorientues pasi ato që përforcohen janë partitë e mëdha më shumë se së proporcionaliteti.

Perzgjehja dhe efektet e sistemeve elektorale ne Shqiperi

Përveç se në dukje një proces politik i pakthyeshem, tranzicioni nga sistemi një-partiak në sistemin pluralist do të duhej që ti nënshtrohej dy proceseve paralele. Së pari, procesit të demokratizimit të institucioneve të shtetit ekzistues, i cili duhej që të lejonte organizimin e zgjedhjeve shumëpartiake dhe së dyti, procesit të krijimit të kuadrit institucional për konkurimin ndërmjet partive. Me rëndësi themelore për ecurinë e këtyre proceseve ishte fakti se vetë aktorët pjesmarrës procese do të ishin konkurues në zgjedhjet e ardhëshme, dhe eventualisht edhe humbës.

Përsa i përket demokratizimit të institucioneve dhe lejimin e mbajtjes së zgjedhjeve, fundi i regjimit komunist në Rumani (CSCE 1991) dhe vështirësitë ekonomike (Pashko 1993) e detyruan elitën partiake dhe burokratike që t'i pranonte zgjedhjet shumëpartiake dhe krijonte kushte për lejimin e partive politike (Dekret 1990). Por ndërsa demokratizimi i institucioneve ishte kryesisht rezultat i ndikimit të faktorëve të jashtëm, krijimi i kuadrit institucional për konkurimin ndërmjet partive, lidhet me shmë me faktorë të brendshëm.

Në vendet ish-komuniste të Europës Qëndrore dhe Lindore (EQL) lëvizje të gjera shoqërore apo fraksione reformiste brenda partive komuniste u bënë udhëheqës të proceseve të tranzicionit dhe pjesmarrës në zgjedhjet e para demokratike (Lewis 2001). Nëpërmejt Tryezave të e Rrubullakëta të Bisedimeve (TRB) u negociuan shumë aspekte të tranzicionit, përfshirë sistemet elektorale.¹⁰

Në ndryshim nga zhvillimi i proceseve të tranzicionit në këto vende, në Shqipëri Partia e Punës e Shqipërisë (PPSH) nëpërmjet regjimit të kontrolluar prej saj ngeli aktor politik dominues deri në zgjedhjet e para pluraliste (Vickers and Pettifer 1997). Kjo e lejoi të marrë e vetme shumicën e vendimeve të tranzicionit, përfshirë përzgjedhjen e mazhoritar me shumicë absolute. Ky model përdorej në shumicën e vendeve komuniste, por nëpërmjet negociatave pothuaj të gjitha këto vende kaluan në sistemin proporcional ose miks proporcional (Bielasiak 2006).¹¹ PPSH e cila zgjodhi si strategji elektorale konkurrimin nëpërmjet personaliteteve të cilat ishin të njohura nga elektorati nuk e ndryshoi sistemin i cili lejonte shfrytëzimin e bazës ekzistuese të kanalizimit të pushtetit nëpërmjet klientelizmit dhe marrdhënieve personale (Birch 2005).

Por në këtë përzgjedhje PPSH u favorizua edhe nga kushtet specifike të zhvillimeve të tranzicionit të hershëm. Së pari, në momentin e krijimit të

10. Në Gjermaninë Lindore dhe Çekosllovakia, partitë në pushtet kapitulluan tërësisht duke mos marrë asnjë përfitim paraprak. Në Poloni Partia Komuniste arriti të negocionte marrjen e 65 përqind të vendeve në dhomën e ulët të parlamentit; në Hungari dhe Bullgari opozita arriti të siguronte një sistem elektorale miks proporcional favorizues për ta. Rumania ishte i vetmi vend ku regjimi u përmbys me revolucion dhe ku Fronti i Shpëtimit Kombëtar organizoi zgjedhjet në mënyrë të njëanshme

11. Përveç Shqipërisë, Blëlorusisë dhe Maqedonisë.

Partisë Demokratike, si partia e parë opozitare, Shqipëria praktikisht gjendej në fushatë elektorale pasi mandati i legjislaturës ishte përcaktuar që të rinovohej në zgjedhjet e 10 shkurtit 1991. Së dyti, duke qënë nën presionin e alternativës së mbajtjes sa më parë të zgjedhjeve apo organizimit të tyre nëpërmjet negociatave më të gjata, PD megjithse fillimisht kërkoi ndryshimin e sistemit në proporcional hoqi dorë pasi iu rrit besimi në fitore (Elster 1991).

Nga 11 parti dhe organizata që morën pjesë në zgjedhje tre prej tyre hynë në parlament.¹² PPSH fitoi 56 përqind të votave dhe 68 përqind të vendeve të parlamentit 250 vendësh.¹³ PD fitoi 39 përqind të votave dhe 30 përqind të vendeve dhe së bashku PPSH përbënin 97 përqind të vendeve. Partia e tretë që hyri në parlament ishte shoqata OMONIA e minoritetit grek e cila fitoi 0.73 përqind të votave dhe mori 2 përqind të vendeve.

Përveç përfitimeve nga pozita e pushtetit, të cilat e vunë në diskutim legjitimitetin e fitores së PPSH (CSCE 1991), efektet e prodhuara nga sistemi ishin brenda pritshmërive të sistemeve mazhoritare. Dominimi i parlamentit nga dy parti politike ishte rikonfirmimi i ligjit të Duverger se sistemet mazhoritare prodhojnë sistem dy-partiak (Duverger 1954). Edhe hyrja e shoqatës OMONIA të minoritetit grek ishte në përputhje me pritshmëritë e sistemit i cili favorizon partitë e vogla kur këto kanë përqëndrim gjeografik të votuesve (Norris 1997). Shkalla e shpërpjestueshmërisë prej 10.16 përqind ishte në kufijtë më të ulët që prodhojnë sistemet mazhoritare (Lijphart 1999) dhe ishte tregues se partitë politike nuk kishin përdorur strategji për të shmugur kufizimet e sistemit për të mbrojtur përfaqësueshmërinë (Grafik 1).

Përveç efekteve të menjëhershme, rezultatet e këtyre zgjedhjeve patën edhe efekte afatgjata, pasi dy partitë që dolën fitueset kryesore nga këto zgjedhje do ta përdornin këtë mundësi për ruajtjen dhe përforsimin e pozitave të fituara. Sipas Sartorit, momenti i strukturimit fillestar të sistemit të partive është vendimtar pasi rrjedhja e ngjarjeve të mëvonshme përcaktohet nga ato parti që përfitojnë nga mundësitë e krijuara në këtë fazë të procesit (Sartori 1968).

Kështu fitorja e zgjedhjeve të para nga PPSH ishte përcaktuese edhe në formësimin e spektrit ideologjik. Në mungesë të ndarjeve sociale tradicionale të cilat në demokracitë perëndimore kishin shërbyer si baza të formimit të partive politike (Lipset & Rokkan 1967), vetë mbijetesa e PPSH dhe mbështetja elektorale që ajo siguroi shërbeu si bazë për një ndarje të re. Ndërkohë që PPSH arriti të dominojë njërin pol të tregut elektoral, polin

12. Nga pesë organizatat e afiljuara me PPSH që konkuruan në zgjedhje, Bashkimet Profesionale, Fronti Demokratik, Bashkimi i Grave, Bashkimi i Rinisë dhe Komiteti i Veteranëve, vetëm ky i fundit fitoi një vend në parlament (ose 0.4 përqind të vendeve).

Përqindja e votave të Komiteti i Veteranëve është llogaritur këtu i mbledhur me ato të PPSH.

13. Në këtë përqindje përlllogaritjet dhe 1 vend i fituar nga Komiteti i Veteranëve.

tjetër e fitoi PD. Për më tepër, efekti shtrydhës i sistemit mazhoritar mbi partitë që zënë të njëjtin vend në spektrin ideologjik (Ishiyama 1995) e nxiti më tepër krijimin e një strukture bipolare konkurimi duke e kufizuar potencialin e alternativave të treta. Kjo prirje ishte konfirmim i pohimit të Duverger se kur opinioni publik përballohet me probleme madhore tendenca natyrale e preferencave shkon drejt kristalizimit të dy poleve të kundërta (Duverger 1954).

Paqëndrueshmëria e kabineteve qeverisëse, e shkaktuar kriza e gjithashme ekonomike dhe politike, çoi në zgjedhje parlamentare të parakohshme të cilat u mbajtën në mars të vitit 1992. Perceptimi i PD se PPSH kishte fituar zgjedhjet nga favorizimi prej sistemit mazhoritar e kishte bërë ndryshimin e sistemit një nga çështjet kryesore politike. Ndryshe nga zgjedhjet e para, në këtë rast përzgjedhja e sistemit ishte rezultat i ndërveprimit dhe forcës së të gjitha partive politike të cilat e influencuan procesin nga pozicionet e tyre të ndryshme. Duke synuar një sistem nga i cili të përfitonin sa më shumë (CSCE 1992) preokupimet e partive në përzgjedhjen e sistemit të ri, reflektonin rezultatin e zgjedhjeve të mëparshme dhe adoptimin e një sistemi i cili të minimizonte sa më shumë pasiguritë mbi rezultatin e ardhshëm.

PD e cila kishte parë përfitimin e PPSH nga sistemi mazhoritar do të mund të përfitonte nga ruajtja e të njëjtit sistem, pasi mbështetja elektorale e saj ishte rritur. Por si përfaqësuesja kryesore e forcave që kërkonin demokratizimin e shpejtë të vendit, PD mbështeste një sistem të bazuar në parimin e proporcionalitetit. Nga ana tjetër, një sistem proporcional i hapur ndaj përfaqësimit rrezikonte fragmentimin e elektoratit të PD për shkak se numri i partive opozitare ishte më i madh, ndërsa Partia Socialiste (PS) edhe pse në rënie vazhdonte të kishte mbështetje elektorale më kompakte.¹⁴ Kështu, si një nga dy partitë më të mëdha që mund të vendosnin në parlament për llojin e sistemit, PD u orientua drejt përzgjedhjes së një sistemi i cili më së miri reflektonte pozicionin e saj të ri. Duke e parashikuar fitoren, PD synoi një sistem i cili të prodhonte një shumicë të qëndrueshme, të bazohej në parimin e proporcionalitetit dhe të ngushtonte tregun elektorale në disfavor të PS nëpërmjet lejimit të mundësisë së hyrjes së partive të tjera, por nga ana tjetër të shmangte fragmentimin e votave të opozitës. Pragu elektorale prej 4 përqind ishte një barrierë e lartë dhe ulte mundësinë e përfaqësimit në parlament të partive të vogla duke favorizuar deri dy-partizmin dhe për pasojë PS. Por përballë alternativës së fragmentimit të kampit opozitar, PD mundi të pranonte sistemin miks proporcional si alternativën më të përshtatshme për të pasi në tërësi ajo

14. Në qershor 1991 PPSH e ndryshoi emrin në Partia Socialiste e Shqipërisë

parashikonte të dilte më e fituar nga kjo përzgjedhje.

Megjithëse PS ishte partia me e madhe në parlament ajo ishte dobësuar nga ndarjet midis konservatorëve dhe reformistëve. Për shkak të rritjes së mbështetjes elektorale sistemi ekzistues do të mund ti jepte PD një fitore edhe më të madhe se PS. Kështu PS ishte e interesuar për një sistem nëpërmjet të cilit të minimizonte sa më shumë humbjen. Sistemi miks proporcional dhe formula kompensuese sipas të cilës partia që merr më pak vota në sistemin mazhoritar kompensohet me vende nga lista e proporcionalit, ishte garanci për PS që të dilte nga zgjedhjet si një nga dy partitë e mëdha. Duke qënë se edhe PS ishte e interesuar që të ruante kompaktësinë e elektoratit të majtë dhe shmangte fragmentimin edhe ajo mbështeste një prag të lartë elektorale.

Përputhja e këtyre preferencave çoi në përzgjedhjen e Sistemit Miks Proporcional (Ligj 1992), i cili përdorej në Gjermani dhe njihej për proporcionalitetin në përfaqësueshmëri dhe qeverisjen e efektshme (Lijphart 1999). Madhësia e legjislaturës u zvogëlua nga 250 në 140 vende. Nga këto, 100 vende do të zgjidheshin në zonat njëemërore ku do të përdorej sistemi mazhoritar me formulë të shumicës absolute, ndërsa 40 vendet plotësuese do t'u shpërndaheshin në mënyrë proporcionale, kandidatëve të listave të partive në bazë të proporcionit të votave të fituara në raundin e parë. Për të përfituar nga formula e sistemit proporcional më lista shumëemërore të mbyllura partitë duhet të arrinin pragun elektorale prej 4 përqind të votave në shkallë vendi.

Partitë më të vogla synonin një sistem proporcional me një prag më të ulët por ato nuk ishin në pozita për të imponuar preferencat e tyre.¹⁵ Sodoqoftë ato ndikuan indirekt në procesin e përzgjedhjes së sistemit dhe në formësimin e strategjive elektorale pasi partitë më të mëdha nuk kishin si të mos merrnin në konsideratë vetë ekzistencën dhe potencialin shantazhues të tyre (Sartori 1976).

Meqënëse si partitë e mëdha ashtu edhe ato më të vogla identifikoheshin me udhëheqësit e tyre, i vetmi element i sistemit të ri të cilin të gjitha partitë e mbështesnin ishte garancia që jepte lista e shumëemërore e proporcionalit për hyrjen në parlament të udhëheqsve të partive e cila shmangte përsëritjen e eksperiencës çnderuese të zgjedhjeve të vitit 1991 (Vickers & Pettifer 1997).¹⁶

Megjithë kalimin nga sistemi mazhoritar në sistemin miks proporcional, zgjedhjet prodhuan një përfaqësim gati identik më zgjedhjet e para përse i përket shpërndarjes së vendeve në parlament dhe dominimit të sistemit nga

15. Përveç PS dhe PD në negociatën ishin të përfshira edhe parti më të vogla ku më të rëndësishmet ishin Partia Republikane (PR), Partia Social Demokrate (PSD), dhe partia e minoritetit grek OMONIA e cila ishte transformuar në Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ).

16. Në zgjedhjet e marsit 1991 megjithëse PPSH fitoi 70 përqind të vendeve në parlament disa nga udhëheqësit e saj kryesorë si Presidenti Ramiz Alia, Ministri i Jashtëm Muhamet Kapllani dhe Ministri i Arsimit Skënder Gjinushi nuk arritën të fitojnë në zonat e tyre, ndërsa Kryeministri Fatos Nano arriti të fitonte vetëm mbas raundit të dytë.

dy parti. PS dhe PD së bashku fituan 92 përqind të vendeve në parlament. Përveç partisë së minoritetit grek e cila ishte shndërruar në Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ), sistemi proporcional favorizoi përfaqësimin e dy partive të tjera, Partisë Social Demokrate (PSD) dhe Partisë Republikane (PR) (Tablela 3). Megjithatë përfaqësimi i këtyre dy të fundit paraqitej problematik pasi ato më së shumti e kishin arritur këtë rezultat për shkak të mbështetjes me vota nga elektorati i PD. PD së bashku me PSD dhe PR ishin bashkuar në një front kundër PS duke rënë dakord që të mos mbështesnin PS dhe të mos konkuronin kundra njëra tjetrës në zonat respektive (CSCE 1992). Për të mbështetur dy aleatët më të vegjël, PD tërhoqi kandidatët e saj në tre zona elektorale duke i hapur rrugë strategjisë së të ashtuquajturave 'zona të lira'. Kjo strategji u gjet si formë për anashkalimin e kufizimeve të sistemit pasi partitë aleate rrezikonin të mos e arrinin pragun elektoral prej 4 përqind. Meqënëse votat e marra në raundin e parë në zontat njëemërore përdorshin për të përlogaritur vendet që do të shpërndaheshin në proporcional, kjo formë u pa si mundësi për të marrë votat e nevojshme për arritjen e pragut.

E përdorur për herë të parë në këto zgjedhje, strategjia e ndarjes së votës dhe transferimit të tyre tek aleatët do të përdorej sistematikisht në të gjitha zgjedhjet e mbajtura me këtë sistem si manovër për të maksimizuar rezultatin e koalicioneve.

Me gjithë pakënaqësinë e PD për kompensimin e PS, e cila fitoi vetëm 6 vende në ballafaqimin në zonat njëemërore por u kompensua me 32 vende nga lista e proporcionalit (Haçi 2000), sistemi reflektoi me korrektësi parimin mbi të cilin është ndërtuar: përkthimin e vendeve në parlament duke iu afuar sa më shumë përqindjes së votave. Kështu PD më 62.3 përqind të votave kishte marrë 65.7 përqind të vendeve ndërsa PS me 25.7 përqind të votave kishte marrë 27.1 përqind të vendeve. Sistemi prodhoi më pak shpërpjestueshmëri se sa sistemi i mëparshëm dhe do të shënonte shpërpjestueshmërinë më të ulët në të gjitha zgjedhjet legislative (Grafik 1). Numri efektiv i partive nuk i kaloi 2 dhe sistemi nuk arriti të sfidonte sistemin dy-partiak të dalë nga zgjedhjet e mëparshme duke demonstruar se në kushtet e mungesës së orientimit të elektoratit sipas ndarjeve klasore, orientimet politike natyrshëm marrin formën e zgjedhjes midis dy alternativave. (Duverger 1954). Hyrja e PSD në parlament si partia e tretë por vetëm nëpërmjet transferimit të votave dhe strategjisë së 'zonave të lira' e konfirmonte më së miri këtë pohim.

Dy ballafaqime të tjera elektorale, të cilat ndodhën në periudhën midis dy

zgjedhjeve u përdorën nga partitë si prova për të matur mbështetjen e tyre. Zgjedhjet e para pluraliste për pushtetin lokal të mbajtura në shtator 1992 prodhuan një rezultat gati të barabartë ku PS fitoi 41.3 përqind dhe PD fitoi 43.2 përqind të votave. Po kështu në referendumin për miratimin e Kushtetutës, i cili u kthye në një ballafaqim politik (Omari), PD e cila kërkonte miratimin e draftit mori mbështetjen e vetëm 42 përqind të elektoratit. Mbas shkëputjes së Aleancës Demokratike (AD) dhe largimit të PSD dhe PR nga koalicioni, PD i pa ndryshimet e sistemit elektoral si një në mënyrë për të minimizonte pasiguritë mbi rezultatin e zgjedhjeve të ardhshme.

Duke qënë se kishte shumicën e nevojshme parlamentare PD e përdori këtë pozitë për të bërë ndryshime në sistemin elektoral që do të përdorej në zgjedhjet e ardhshme. Arsyetimi kryesor mbështetej në përfitimin e 'tepruar' (Haçi 2000) të PS në zgjedhjet e vitit 1992, ku ajo u kompensua me 80 përqind të votave të listës së proporcionalit. Për të shmangur pësëritjen e të njëjtit skenar, sistemit iu modifikua formula e shpërndarjes së vendeve sipas listës shumëemërore të proporcionalit nga 'plotësuese' në 'mbivendosëse'. Ndryshimi minonte parimin e proporcionalitetit pasi për nga rezultatet që prodhon kjo formulë qëndron diku midis sistemeve mazhoritare dhe proporcionalit të pastër (Massicotte & Blais 1999). Madhësia e zonave zgjedhor u ndryshua, duke e rritur në 115 numrin e zonave njëemërore me shumicë absolute. Madhësia e zonës shumëemërore me lista të mbyllura u zvogëluar në 25 vende. Vendet e listës shumëemërore do të shpërndaheshin sipas një Kuote.¹⁷ Struktura e votës ndryshoi dhe votuesit do të kishin dy vota, një për kandidatët që konkuronin në mazhoritar dhe një për listat e partive.¹⁸ Sipas formulës mbivendosëse nëse një parti kishte fituar 60 përqind të votave të hedhura për listat e partive, ajo parti do të merrte 60 përqind të 40 vendeve të rezervuara për proporcionalin. Kjo në fakt e shkëputte ndërlidhjen midis rezultateve të të dy formulave. Pragu elektoral u përcaktua 4 përqind për partitë, ndërsa pragu 8 përqind për koalicionet ishte një barrierë për të dekuarajuar koalicione të mundshëm të PS me partitë e vogla të cilat nuk ishin më aleatë të PD (Ligj 1996). Një masë tjetër për të minimizuar pasiguritë e rezultatit ishte ripërcaktimi i zonave zgjedhore që përqëndronin votuesit dhe rrisnin sigurinë e fitores në mazhoritar. Kjo manovër i dekurajonte partitë që të bënin fushatë për të tërhequr 'votuesit e lëkundur' duke nxitur 'faktorin psikologjik' drejt mbështetjes për partinë fituese (Duverger 1954). Për të favorizuar partitë aleate PD përdori strategjinë e 'zonave të lira' duke mos vendosur kandidatë në disa zona njëemërore.

17. Llogaritet shuma e votave të vlefshme të hedhura në raundin e parë për mandatet shtesë për subjektet elektorale, pastaj gjendet shuma e votave të vlefshme të hedhura për secilin nga subjektet. Numri i votave të vlefshme të secilit prej këtyre subjekteve pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme të hedhura për mandatet shtesë dhe thyesa që del shumëzohet me numrin 25 të mandateve shtesë.

18. Praktikisht votuesit kishin një fletëvotimi por ajo ishte e ndarë në dy pjesë dhe votuesit vendosin dy shënja, një për kandidatët dhe një për listen e partive. Pamvarësisht vendosjes fizikisht në një fletëvotimi, ky konsiderohet si votim me dy vota.

Problemet me administrimin e zgjedhjeve (CSCE 1996) treguan se në rastet kur politikanët vihen përballë dëshirës për të qëndruar në pushtet dhe të ruajtjes së legjitimitetit demokratik ata janë të gatshëm ta vënë në diskutim legjitimitetin kur e shikojnë se manipulimet janë shpërblyese (Birch 2007). Por përveç problemeve administrative, modifikimi i sistemit në mënyrë të tillë që të favorizonte PD veçse konfirmoi konkluzionin e Lipset dhe Rokkan se 'strategët e partive kanë ndikim vendimtar mbi legjislacionin zgjedhor dhe zgjedhin ato sisteme që më së shumti mund të konsolidojnë pozitën e tyre' (Lipset & Rokkan 1967: 115). Me 122 nga 140 vendet në parlament, PD së bashku me partitë aleate kontrollonte 92 përqind të vendeve, duke shënuar rezultatin më të thellë të arritur ngë një parti që në zgjedhjet pluraliste (Tabela 3). Formula 'mbivendosëse' prodhoi një shpërpjestueshmëri të lartë prej 25 përqind, e cila duke qënë dy herë e gjysëm më e lartë se shpërpjestueshmëria që prodhoi sistemi mazhoritar në vitin 1991, tregonte se modifikimet në formulë e kishin minuar konceptin e proporcionalitetit. Po kështu përfaqësimi i PD në parlament më 87.1 përqind të vendeve e uli numrin efektiv të partive në 1.3, më i uli në të gjitha zgjedhjet (Grafik 1).

Kriza e vitit 1997 dhe pasojat që vijuan çoi në nevojën e përtëritjes së legjitimitetit qeverisës nëpërmjet zgjedhjeve të reja. Ndryshimi i sistemit elektoral u pa përsëri nga partitë si instrument për konsolidimin e pozitave të tyre në sistemin politik. PD mbështeste kthimin tek sistemi mazhoritar, të cilin në ato kushte e shihte si më të favorshëm, ndërsa partitë më të vogla të cilat ishin rritur në numër, preferonin një sistem proporcional me prag të ulët (CSCE 1997). Megjithatë në thelb sistemi miks mazhoritar nuk ndryshoi, përveç disa modifikimeve në elementët e formulës. Madhësia e legjislaturës u rrit në 155 vende, nga të cilat 115 do të zgjidheshin sipas mazhoritarit me formulë të shumicës absolute në zonat njëemërore, ndërsa 40 vende do t'u shpërndaheshin partive sipas të njëjtës formulë mbivendosëse, si në zgjedhjet e vitit 1996. Pragu elektoral u ul në 2 përqind. Rritja e madhësisë së legjislaturës mund të shihet si një manovër kompensuese kundrejt uljes së pragut elektoral për të akomoduar partitë më të vogla por pa çënuar peshën absolute të partive më të mëdha.

PS, e cila mbas zgjedhjeve të diskutueshme të vitit 1996 ishte më e preokupuar për administrimin e procesit, pasi rezultati mund të manipulohet pamvarsisht sistemit të përdorur, i pranoi ndryshimet në formulë por duke kërkuar më shumë garanci për transparencën e procesit (CSCE 1997).

Megjithëse PD e përdori deri në fund pozitën e saj me shumicën në parlament për të miratuar një sistem të favorshëm për të, rezultati i zgjedhjeve të vitit 1997 favorizoi më së shumti PS dhe partitë e vogla. Ulja e pragut elektoral në 2 përqind bëri që për herë të parë në parlament të hynin 11 parti, 1 koalicion dhe 3 deputetë të pavarur. Rritja e numrit të partive parlamentare demostroi se pragu më i lartë elektoral i aplikuar në dy zgjedhjet e mëparshme kishte funksionuar si barrierë për partitë e vogla (Tabela 3). Përsa i përket përfaqësueshmërisë, shpërpjestueshmëria në këto zgjedhje ishte më e vogël se në zgjedhjet e mëparshme por përsëri tepër e lartë për pritshmëritë e sistemit miks proporcional. Për herë të parë dy partitë e mëdha kontrollonin vetëm 82.5 përqind të vendeve në parlament dhe numri efektiv i partive ishte rritur në 2.2 (Grafik 1).

Miratimi i Kushtetutës u pa si një rast i përshtashëm për të dekurajuar ndryshimin e sistemit nga partitë dhe Kushtetua e vitit 1998 përcaktoi bazat e sistemit elektoral. Modeli që u përgjodh ishte sistemi i përdorur në zgjedhjet e vitit 1992: miks proporcional me madhësi legjislature me 140 vende nga të cilët 100 do të zgjidheshin në zonat njëemërore dhe 40 nga lista shumëemërore e partive. Kushtetuta përcaktonte pragun elektoral 2.5 përqind për partitë dhe 4 përqind për koalicionet. Duke qënë se Kushtetuta u hartua nga një parlament i cili ishte më pluralisti deri në ata kohë, përzgjedhja e pragut elektoral relativisht të ulët reflektonte forcimin e pozitave të partive më të vogla.

Specifikime të mëtejshme të formulës liheshin për tu përcaktuar me ligj (Ligj 2000). Ligji përcaktoi formulën e shumicës absolute për votimin në 100 zonat njëemërore dhe formulën për shpërndarjen e 40 vendeve të proporcionalit sipas listës së partive, e cila këtë radhë do të ishte 'kompensuese', e njëjtë me formulën e përdorur në zgjedhjet e vitit 1992.¹⁹ Votuesit do të kishin dy vota të veçanta, një për kandidatët dhe një për listën.

Formula e shumicës absolute dhe votimi me dy raunde i jepnin mundësinë partive politike të përdornin më me lehtësi strategjine e ndarjes së votës për të mbështetur alealët dhe rritur përfitimin e tyre elektoral. Ndryshe nga PD e cila krijoi koalicion parazgjedhor me partitë aleate të qëndrës së djathtë, PS zgjodhi si strategji që të mos hynte në koalicion parazgjedhor me partitë aleatë të saj.²⁰ Kjo përlllogaritje bënte që ato të përfitonin nga pragu më i ulët elektoral prej 2.5 përqind për partitë në shpërndarjen e vendeve nga lista shumëemërore e proporcionalit. Duke qënë se PS fitoi 73 vende nga zonat njëemërore dhe për pasojë nuk përfitonte nga formula kompensuese ajo

19. Formula për llogaritjen e shpërndarjes së vendeve kompensuese sipas Kodit Zgjedhor - Numri i votave të vlefshme të fituara nga çdo parti ose koalicion, që kalon pragun përkatës, pjesëtohet me shumën e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në shkallë vendi dhe rezultati shumëzohet me 140. Secilës prej këtyre partive ose koalicioneve i caktohet fillimisht një numër i përgjithshëm mandatesh, i barabartë me numrin e plotë që del nga llogaritja e mësipërme. Mandatet që mbeten u caktohen partive ose koalicioneve me mbetjet dhjetore më të mëdha.

20. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë, Partia Agrare Ambientaliste, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Aleanca Demokratike

instruktoi votuesit e saj që në raundin e dytë të votonin për katër partitë aleate të qeverisjes së mëparshme. Vetëm me votat e marra në listën shumëemërore në një zonë elektorale,²¹ PSD, PBDNJ, AD, dhe Partia Agrare Ambientaliste (PAA) arritën pragun prej 2.5 përqind dhe përfituan 9 vende në parlament. Pa këtë strategji ato vende do t'i kishte fituar PD (Tabela 3).

Megjithë ndarjen e votës dhe transferimin për partitë e vogla, formula 'kompensuese' e përdorur për shpërndarjen e vendeve të listës së proporcionalit prodhoi një shpërpjestueshmëri më të ulët por përsëri krahasimisht shumë më të lartë se ajo që ky sistem prodhon nëse aplikohet me korrektësi. Nëse PS nuk do të kishte ndjekur strategjinë e ndarjes së votës shpërpjestueshmëria do të kishte qënë në kufij të krahasueshëm me zgjedhjet e vitit 1992 (Grafik 1).

Për të shmangur zgjatjen e procesit zgjedhor (OESC 2001)²² dhe dekurajuar partitë nga përdorimi i strategjisë së ndarjes së votës, e cila lehtësohej nga votimi me dy raunde, sistemi u ndryshua pjesërisht. Për zgjedhjen e 100 vendeve në zonat njëemërore do të përdorej formula e shumicës së thjeshtë me një raund. Ndërsa mënyra e shpërndarjes së 40 vendeve sipas listës proporcionale ngeli e pandryshuar.

Duke parashikuar se do të fitonin aq vota në zonat një-emërore sa të skualifikoheshin nga kompensimi në proporcional PD dhe PS zgjodhën si strategji ndarjen e votës në të njëjtën mënyrë si në zgjedhjet e mëparshme.²³ Dallimi qëndronte në faktin se kjo strategji do të aplikohet në të gjitha zonat dhe nga të gjitha partitë. Për këtë arsye kjo strategji u emërtua 'Mega Dushk'.²⁴ Për të realizuar këtë strategji, duke qënë se sistemi parashikonte vetëm një raund ato krijuan koalicione parazgjedhore dhe gjatë fushatës elektorale instruktuan zgjedhësit për të votuar për kandidatët e PD dhe PS në zonat një-emërore dhe për partitë aleate respektive në listat shumëemërore.

Nëpëmjet strategjisë 'Mega Dushk', nga 8.8 përqind të votave të fituara për aleatët në zgjedhjet e vitit 2001, PS kontribuoi në rritjen e sasisë së votave për to në 30 përqind.²⁵ Me këtë përqindje ato u kompensuan me 16 nga 40 vendet e listës proporcionale (Tabela 3).

Por megjithëse të dy partitë zgjodhën të njëjtën strategji, PD me Aleancën për Liri, Drejtësi dhe Mirëqenie (ALDM) arriti të merrte më shumë vende në parlament pasi zgjedhja për të hyrë në një koalicion me më shumë parti i dha numër më të madh votash koalicionit.²⁶

Strategjia e përdorur nga dy partitë më të mëdha dhe aleatët e tyre krijoi trysni mbi partitë e vogla të cilat nuk hynë në koalicion me asnjë nga dy

21. Në zonën elektorale të Dushkut

22. I cili zgjati për rreth dy muaj

23. Në fakt PS dhe PD fituan 98 vende në zonat njëemërore, aq sa në zgjedhjet e vitit 2001, kështu që vendet e e listës shumëemërore do t'i

shpërndaheshin partive sipas votatave jashtë kontrollit të tyre.

24. Zona zgjedhore njëemërore ku kjo strategji u aplikua për herë të parë në vitin 2001.

25. Partia Socialdemokrate e Shqipërisë (PSD), Partia Agrare Ambientaliste (PAA), Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë, Aleanca Demokratike (AD)

26. Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar (PBDSh), Bashkimi Liberal Demokrat (BLD), Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (LDLNj), Partia Balli Kombëtar Demokrat (PBKD), Partia Demokristiane e Shqipërisë Aleanca për Liri (PDK), Partia Demokrate e Re (PDR), Partia Republikane (PR).

partitë më të mëdha dhe që arritën të kalojnë pragun elektoral. Nëse PS dhe PD nuk do të kishin ndjekur strategjinë e ndarjes së votave, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)²⁷ e cila mori 8.4 përqind të votave dhe PBDNJ e cila mori 4.1 përqind të votave, do të kishim marrë secila 13 dhe 6 vende.²⁸

Strategjia e ndarjes së votës dhe e anashkalimit të kufizimeve të sistemit prodhoi nivelin më të lartë të shpërpjestueshmërisë në të gjitha zgjedhjet pluraliste por edhe në nivele të paparashikuara nga sistemet mikse proporcionale. Si rezultat i transferimit të votave tek partitë më të vogla numri efektiv i partive u rrit në 3.8 duke e rritur ndjeshëm peshën e tyre në parlament (Grafik 1).

Ajo që vihet re pas dy zgjedhjeve të mbajtura me sistemin elektoral të përcaktuar në Kushtetutë është fakti se për shkak se partitë politike ishin të kufizuara ndaj ndryshimeve të thelbësore të sistemit ato adoptuan strategji të cilat e anashkalonin atë. Ulja e pragut elektoral në zgjedhjet e vitit 1997 dhe rritja e numrit të partive parlamentare shkaktoi një tkurrje graduale në përfaqësimin e dy partive të mëdha në parlament por nga ana tjetër shtimi i numrit të tyre krijoi mundësi për strategji më të sofistikuara bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërmjet partive politike.

Një nga efektet e paparshikuara të këtyre strategjive ishte shtimi në parlament i partive të vogla dhe rritja e potencialit të tyre shantazhues (Sartori 1976). Rezultati i zgjedhjeve lokale të vitit 2007, ku PD dhe PS fituan 21.8 dhe 24.8 përqind të votave respektivisht (OESC 2007), mund të shihet si pika e kthesës e cila i bëri dy partitë më të mëdha që të shihnin si rrezik më të madh jo njëra tjetrën por fragmentimin e mëtejshëm të pushtetit dhe rritjen e forcës së partive më të vogla në dëm të tyre. Nga ana tjetër 'dezertimi' i PAA nga koalicioni me PS mbasi kishte përfituar nga strategjia e ndarjes së votës dhe hyrja në koalicion qeverisës me PD tregoi se 'investimi' i mëtejshëm nga partitë e mëdha tek partitë e vogla ishte i pasigurt.

Në këto kushte vendimi i PS dhe PD për të dryshuar sistemin zgjedhor të përcaktuar nga Kushtetuta përputhet me strukturën e sjelljes së deriatëhershme të partive politike për të modifikuar sistemin elektoral kur shkalla e pasigurisë përballë formacioneve të tjera politike rritet. Veçantia e ndryshimeve të kësaj radhe qëndron në faktin se ndryshimi i sistemit bazohej në interesa bipartizane të dy partive më të mëdha, të cilat u bashkuan për të marrë 'masa' përballë rritjes së 'pakontrolluar' të partive më të vogla (Grafik 2 dhe 3).

Përzgjedhja e një sistemi brenda formulës proporcionale, duket se ishte e kushtëzuar nga vetë lidhja midis sistemit proporcional dhe demokratizimit

27. *Parti e shkëputur si fraksion i PS në vitin 2004.*

28. *Kjo përlllogaritje është bërë duke marrë votat e listës së proporcionalit duke përjashtuar votat e përfituara nga partitë e tjera si rezultat i transferimit prej partive të mëdha pra duke llogaritur PD me 41.1 përqind dhe PS me 37.2 përqind, që është shumica e votave të marra si koalicione në lista.*

të vendeve më të sukseshme post komuniste të EQL, ndërkohë që sistemet mazhoritare gjejnë përdorim sot vetëm në vendet gjysëm-autoritariste ish republika të Bashkimit Sovietik (Bielasiak 2006).

Për të ndenjur brenda formulës së sistemit proporcional inxhinieria elektorale gjeti zgjidhjen tek sistemi proporcional me disa zona zgjedhore shumë-mërore i cili përdoret në Greqi dhe Spanjë. Për ndarjen e zonave sistemi bazohen në 12 qarqet administrative të vendit. Pragu elektoral u përcaktua 3 përqind për partitë dhe 5 përqind për koalicionet (Ligj 2008). Në rast se sistemi proporcional do të ishte më një zonë zgjedhore, madhësia e zonës do të ishte e barabartë me madhësinë e legjislaturës dhe partitë më të vogla do të ishin më të favorizuara (Lijphart 1999). Me zvogëlimin e madhësisë së zonës nga 140 vende në zona me 4 vende, për zonën më të vogël dhe 35 vende për zonën më të madhe, sistemi në të kundërt i jep avantazh partitve të mëdha.

Për përkthimin e votave në vende në parlament u përcaktua formula përpjestuese D'Hondt për ndarjen fillestare ndërmejt partive,²⁹ dhe formula përpjestuese Sainte-Laguë për ndarjen e vendeve brenda koalicionit.³⁰ Duke qënë se formula Sainte-Laguë shihet si formula që prodhon shpërpjestueshmëri më të vogël (Benoit 2000), është e dukshme se përzgjedhja e formulës D'Hondt për shpërdarjen e votave në fazën e parë të numërimit, është parashikuar si një mekanizëm shtesë në favor të partive të mëdha.

Zgjedhjet e mbajtura me këtë sistem prodhuan një rezultat të ngushtë dhe për herë të parë asnjë nga dy partitë e mëdha nuk arriti të fitojë shumicën absolute të vendeve në parlament për të formuar qeverinë (Tabela 4). Ndryshe nga pritshmëria e sistemeve proporcionale të cilat janë më përfshirëse dhe lejojnë përfaqësim më të madh të partive të vogla numri efektiv i partive doli 2.2. Me kontrollin e 95 përqind të vendeve dy partitë më të mëdha e përforcuan dominimin e tyre në parlament. Po të kihet parasysh se shpërpjestueshmëria që ky model prodhon në vendet e tjera ku përdoret është mbi 8 përqind (Lijphart 1999: 162), shpërpjestueshmëria 7.3 përqind në këto zgjedhje demonstroi se përfaqësimi është brenda pritshmërive të sistemit (Grafik 1).

29. Numra natyrale: 1, 2, 3, 4, 5.....

30. Numra natyrale tekë: 1, 3, 5, 7, 9.....

Konkluzione

Stimujt për ndryshimin e sistemit elektoral kanë rezultuar nga interesi i aktorëve politike për të maksimizuar përfitimin elektoral. Duke ndjekur parimin 'Mikro-mega' (Colomer 2004) stimujt për ndryshimin e sistemit kanë ardhur si nga partitë e mëdha ashtu edhe nga ato të vogla. Partitë e mëdha kanë synuar drejt sistemeve që ngushtojnë kornizat institucionale, ndërsa partitë e vogla i kanë parë ndryshimet si mundësi për të zgjeruar kornizat dhe mekanizmat e përfshirjes në institucionet e dala nga zgjedhjet. Edhe pse sistemi mazhoritar i përdorur në zgjedhjet e para pluraliste mund të shihet si trashëgimi e regjimit të kaluar, sistemi e favorizoi PPSH në mënyrë të dukshme. Megjithëse miratimi i sistemit miks mazhoritar ishte në koherencë edhe me përzgjedhjen e shumë demokracive të reja ish-komuniste efektet që prodhoi kanë qënë jashtë pritshmërive të këtij modeli. Sidoqoftë meqënëse sistemi nuk arriti të konsolidohet për shkak të modifikimeve të vazhdueshme dhe strategjive të partive për anashkalimin e sistemit është e vështirë të bëhet një vlerësim normativ i efekteve.

Konkluzioni kryesor që del nga gjetjet e mësipërme është se përzgjedhja e sistemeve elektorale nuk është orientuar nga nevoja për gjetjen e formulave që garantojnë përfasqsim sa më të mirë dhe qeverisje efektive por nga nevoja për të minimizuar pasigurinë në prag të zgjedhjeve. Por megjithëse ndryshimet e sistemit janë bazuar në përlllogaritjet e aktorëve politikë për të rritur përfitimin elektoral, ato jo gjithmonë kanë rezultuar brenda pritshmërive të tyre. Një nga efektet e paparashikuara të ndryshimeve ka qënë rritja e vazhdueshme e numrit të partive të vogla dhe e kapacitetit të tyre shantazhues (Grafik 3). Kjo qëndron në themel të interesit që shtyu partitë e mëdhë për të realizuar ndryshimin e fundit të sistemit.

Nga pikpamja e sjelljes së aktorëve ndaj sistemit dallohen tre faza. Në fazën e parë, deri në miratimin e sistemit elektoral në Kushtetutë, mungesa e eksperiencës së aktorëve politikë i ka nxitur ata të synojnë përfitime të cilat bazoheshin kryesisht në ndryshimet e sistemit dhe më pak në strategjitë elektorale. Përcaktimi i sistemit nga Kushtetuta i zvogëloi kufijtë e ndërhyrjeve në sistem dhe për pasojë, gjatë fazës së dytë, aktorët politikë u orientuan më shumë drejt strategjive elektorale për të shfrytëzuar mundësitë e sistemit. Faza e tretë fillon me ndryshimin e Kushtetutës dhe është akoma herët të analizohet me të dhënat empirike të një zgjedhje.

Përsa i përket formimit të kabineteve qeverisëse, shumicat e parlamentare të krijuara në dy zgjedhjet e para dhe synimi i partive politike për të arritur

shumica të cilësuar ndikuan në krijimin e kabineteve qeverisëse të 'mbingarkuara' (Lijphart 1999).³¹ Përqëndrimi i qeverisjes dhe zvogëlimi i rolit të opozitës nxiti lindjen e një modeli të ri autoritarizmi i cili do të ndikonte edhe në reformën elektorale të ndjekur në prag të zgjedhjeve të vitit 1996. Si rezultat i konfliktualitetit midis dy partive politike më të mëdha, mundësia e konsensusit për të miratuar politika dhe ligje të cilat kërkonin shumicë të cilësuar ka ardhur duke u zvogëluar vazhdimisht duke nxitur formësimin e modelit të demokracisë mazhoritare ku 'fituesi i merr të gjitha'.

Praktika e koalicioneve me parti 'të tepërta' në krijimin e shumicës parlamentare është përdorur në të gjitha qeverisjet e dala nga zgjedhjet me sistemin miks proporcional. Në fazën e parë koalicionet e 'mbingarkuara' mund të shiheshin si të justifikuara nga interesi i partive për të formuar shumicën e cilësuar për miratimin e Kushtetutës. Por modeli i qeverive me parti të tepërta mbijetoi edhe në fazën e dytë pas miratimit të Kushtetutës, duke pasur në themel krijimin të shumicave për zgjedhjen e Presidentit.

31. Kabinete të cilat përbëhen nga më shumë parti se sa është e nevojshme për të formuar shumicën mbështetëse në parlament.

Bibliografia

- Benoit, Kenneth. 2000. "Which Electoral Formula is the Most Proportional? A New Look with New Evidence." *Political Analysis* 8(4, Autumn): 381-388.
- Benoit, Kenneth. Models of electoral system change, *Electoral Studies* 23 (2004) 363–389
- Bielasia, Jack. Party Competition in Emerging Democracies: Representation and Effectiveness in Post-communism and Beyond Democratization, Vol.12, No.3, June 2005, pp.331–356
- Bielasia, Jack. (2006) 'Regime Diversity and Electoral Systems in Post-Communism', *Journal of Communist Studies and Transition Politics*, 22:4, 407 — 430
- Birch, Sarah. Electoral Systems and Electoral Misconduct, *Comparative Political Studies*, Volume 40 Number 12, December 2007, pp. 1533-1556
- Birch, Sarah. 'Lessons from Eastern Europe: Electoral Reform Following the Collapse of Communism'. Paper presented to a conference on Electoral Reform in Canada, Mt. Allison University, May 10-12, 2005.
- Dekret Nr. 7442, Datë 17.12.1990 Për Krijimin e Organizatave e Shoqatave Politike, Presidiumi e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë
- Duverger, M., 1984. Which is the best electoral system? In: Lijphart, A., Grofman, B. (Eds.), *Choosing an Electoral System: Issues and Alternatives*. Praeger, New York.
- Duverger, Maurice (1954), 'The two Party System and the Multiparty System', in P. Mair (ed.), *The West European Party System*, Oxford, Oxford University Press, 1990
- Dahl, Robert A. *Polyarchy: Participation and Opposition*, New Haven: Yale University Press, 1971
- Elster, Jon. Constitutionalism in Eastern Europe: An Introduction, *The University of Chicago Law Review*, Vol. 58, No. 2, (Spring, 1991), pp. 447-482
- Colomer, Josep M. The Strategy and History of Electoral System Choice in Colomer, Josep ed. (2004) *Handbook of Electoral System Choice*
- Commission on Security and Cooperation in Europe, *The Elections in Albania; March-April 1991*
- Commission on Security and Cooperation in Europe, *Albania's Second Multi-Party Elections March 22 and 29, 1992*
- Commission on Security and Cooperation in Europe, *The Albanian Parliamentary Elections of 1996*
- Commission on Security and Cooperation in Europe, *The Albanian Parliamentary Elections of 1997*
- Haçi, Sopot. *Analiza e zgjedhjeve në Shqipëri, Shtëpia Botuese Koha*, 2000
- Golder, Matt. *Democratic electoral systems around the world, 1946–2000*,

- Electoral Studies 24 (2005) 103–121
- IRI Observation Report on the Albanian Parliamentary Elections of May 26, 1996
 - Ishiyama, John T. Communist Parties in Transition: Structures, Leaders, and Processes of Democratization in Eastern Europe, *Comparative Politics*, Vol. 27, No. 2, (Jan., 1995), pp. 147-166
 - Lewis, Paul G. (2006) 'Party systems in post-communist Central Europe: Patterns of stability and consolidation', *Democratization*, 13:4, 562 — 583
 - Lewis, Paul G. 'The Third Wave' of Democracy in Eastern Europe: Comparative Perspectives on Party Roles and Political Development', *Party Politics* 2001; 7; 543
 - Lijphart, Arend. *Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries*, Yale University, 1999
 - Ligj Nr. 7556, Datë 4.2.1992, Për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë
 - Lewis, Paul G. 'The `Third Wave' of Democracy in Eastern Europe: Comparative Perspectives on Party Roles and Political Development', *Party Politics* 2001; 7; 543
 - Lipset, Seymour M. & Rokkan, Stein. 'Cleavage Structures, Party Systems, and Voter Alignments', in Peter Mair (ed.) *The West European Party System* (Oxford: Oxford University Press, 1990), pp. 91-111.
 - Ligj Nr.8609, Datë 8.5.2000, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë
 - Ligj Nr.10 019, Datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë
 - Ligj Nr.8055, Datë 1.2.1996, Për Ndryshimet në Ligjin Nr.7556, Datë 4.2.1992 "Për Zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë"
 - Massicotte, Louis. & Blais, André´. 'Mixed electoral systems: a conceptual and empirical survey'. *Electoral Studies* 18 (1999) 341–366
 - Norris, Pippa. 'Choosing Electoral Systems: Proportional, Majoritarian and Mixed Systems', *International Political Science Review*, Vol. 18, No. 3, 297-312 (1997)
 - OESC, Office for Democratic Institutions and Human Rights, Republic of Albania Parliamentary Elections, 24 June – 19 August 2001
 - OESC, Office for Democratic Institutions and Human Rights, Republic of Albania Parliamentary Elections, 3 July 2005
 - OSCE, Office for Democratic Institutions and Human Rights, Republic of Albania Local Elections, 18 February 2007
 - Omari, Luan. 'Sistemi Parlamentar: Lindja dhe Evolucioni i Parlamentarizmit ne Shqipëri', *Botimet Eleni Gjika, Tiranë*
 - Pashko, Gramoz. 'Obstacles to Economic Reform in Albania', *Europe-Asia Studies*, Vol. 45, No. 5, (1993), pp. 907-921
 - Przeworski. Adam 1991. *Democracy and the market: Political and economic reforms in Eastern Europe and Latin America* (ch 1). New York: Cambridge

University Press.

- Reynolds, Andrew. Reilly, Ben & Ellis Andrew. The International IDEA Handbook of Electoral Design, Stockholm: International IDEA, 2005
- Riker, William H. The Two-Party System and Duverger's Law: An Essay on the History of Political Science, The American Political Science Review, Vol. 76, No. 4. (Dec., 1982), pp. 753-766.
- Sartori, Giovanni (1968), 'Structuring the Party System' in P. Mair (ed.), The West European Party System, Oxford, Oxford University Press, 1990
- Sartori, Giovanni. (1976) 'A Typology of Party System' in P. Mair (ed.), The West European Party System, Oxford, Oxford University Press, 1990
- Simon, Janos. 'Electoral Systems and Democracy in Central Europe, 1990-1994' International Political Science Review Vol. 18, No. 4, (Oct., 1997), pp. 361-379
- Vickers, Miranda. & Pettifer, James. Albania: From Anarchy to a Balkan Identity, Hurst&Company, London 1997


Aneks

	Zonat zgjedhore					Vota Total	%	Mazhoritar	Proporcional
	1	2	3	4	5				
Partia A	3000	2600	2551	2551	100	10802	43	4	2
Partia B	2000	2400	2449	2449	4900	14198	57	1	3
Total	5000	5000	5000	5000	5000	25000	100	5	5

Tabela 1: Efektet e sistemeve mazhoritare dhe proporcionale kur konkurojnë dy parti (Partia A ka marrë shumë më pak vota se Partia B në total (43% kundrejt 57%), por me sistemin mazhoritar me formulë të shumicës së thjeshtë ajo fiton 4 nga 5 vendet e mundshme. Në të kundërt, sipas sistemit proporcional me listë, i cili për ndarjen e vendeve përdor formulën e mbetjes më të madhe sipas Kuotës Hare, Partia B fiton 3 vende kundrejt 2 vendeve të Partisë B).


	Zonat zgjedhore					Vota Total	%	Vende të fituara	
	1	2	3	4	5			Mazhoritar	Proporcional
Partia A	2000	2000	2000	200	50	6250	25	3	1
Partia B	500	500	500	3750	500	5750	23	1	1
Partia C	500	250	750	1000	3000	5500	22	1	1
Partia D	1000	500	1700	25	1025	4250	17	0	1
Partia E	1000	1750	50	25	425	3250	13	0	1
Total	5000	5000	5000	5000	5000	25000	100	5	5

Tabela 2: Efektet e sistemeve mazhoritare dhe proporcionale kur konkurojnë pesë parti (Me sistemin proporcional edhe pse Partia A ka fituar gati dyfishin e votave të Partisë E, ajo merr po aq vende sa Partia E).




Grafik 1: Numri efektiv i partive dhe shpërpjestueshmëria

(*Si normë e shpërpjestueshmërisë së sistemit mazhoritar është marrë mesatarja e shpërpjestueshmërisë së 14 zgjedhjeve në Britaninë e Madhe. Si normë e shpërpjestueshmërisë së sistemit miks proporcional është marrë mesatarja e shpërpjestueshmërisë së 13 zgjedhjeve në Gjermani dhe si normë e shpërpjestueshmërisë së sistemit proporcional rajonal është marrë mesatarja e shpërpjestueshmërisë së 7 zgjedhjeve në Spanjë (Lijphart 1999))



Grafik 2: Përqindja e votave të dy partive të mëdha dhe shuma e përqindjes së votave të partive të vogla në parlament



Grafik 3: Përqindja e vendeve të dy partive të mëdha dhe shuma e përqindjes së vendeve të partive të vogla në parlament

Partitë	1992					1996					1997					2001					2005				
	Vendet	Votat%	Vendet Proportional	Vendet Total	Vendet %	Vendet Mazhoritar	Votat%	Vendet Proportional	Vendet Total	Vendet %	Vendet Mazhoritar	Votat%	Vendet Proportional	Vendet Total	Vendet %	Vendet Mazhoritar	Votat%	Vendet Proportional	Vendet Total	Vendet %	Vendet Mazhoritar	Votat%	Vendet Proportional	Vendet Total	Vendet %
PD	90	62.3	2	92	65.7	105	55.5	17	122	87.1	16	25.7	11	27	17.4	25	36,8	21	46	32.8	56	7.67	-	56	40
PL	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	0	3.25	2	2	1.29						-	-	-	-	-
PB	-	-	-	-	-	1	5	1	2	1.4	0	2.35	1	1	0.64	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
PR	1	3.1	-	1	0.7	2	5.7	1	3	2.1	1	2.41	1	2	1.29	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
BLD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Bp	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	2	1.29	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
PD	-	-	-	-	-	-	1,3	-	-	-	1	0.07	-	1	0.64	-	1,0	-	-	-	-	-	-	-	-
PD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	5.08	6	6	4.28	-	-	-	-	-
PBDNJ	2	2.9	-	2	1.4	2	4	1	3	2.1	3	2.84	1	4	2.58	-	2.60	3	3	2.14	-	4.13	2	2	1.43
PS	6	25.7	32	38	27.1	5	20.4	5	10	7.1	79	52.5	22	101	65.1	73	41.43	-	73	52.1	42	8.89	-	42	30
PSD	1	4.3	6	7	5.0	-	-	-	-	-	7	2.49	1	8	5.1	-	3.65	4	4	2.8	-	12.74	7	7	5
AD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	2.72	1	2	1.29	1	2.72	1	2	1.29	-	4.76	3	3	2.14
PA	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	0.8	-	1	0.64	1	0.8	-	1	0.64	-	6.56	4	4	2.86
PD	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4,3	2	2	1.43
PU	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	0.07	-	1	0.64	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
LSI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	8.40	4	5	3.57
PA	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3	-	-	3	1.93	2	-	-	2	1.43	1	-	-	1	0.71

Tabela 3: Rezultatet e zgjedhjeve të mbajtura me sistemin miks proporcional

Partitë	Votat %	Totali i vendeve	Vendet %
PD	40.1%	68	48.5
PS	40.8%	65	46.4
LSI	4.8%	4	2.85
PR	2.1%	1	0.7
PBDNJ	1.1%	1	0.7
PDI*	0.95%	1	0.7

Tabela 4: Rezultatet e zgjedhjeve legislative të vitit 2009